



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. ___/___ Prot.

Tiranë, më _____. 2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (i korrigjuar)

Për: **I N T E R M E D Sh.p.k me NIPT J71424020D** me adresë, rruga Ismail Qemali 12/1, Tiranë.

* * *

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur me mjete elektronike- mbi kufirin e lartë monetar.**
Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF- 65289-07-13-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje artikuj për masa mbrojtëse personale për përballimin situatës së Covid-19”- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj**
Fondi limit në total 599,940,000 (pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë e nëntë milion e nëntëqind e dyzet mijë) Lekë pa TVSH”.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): JO Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

* * *

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurën **“Blerje artikuj për masa mbrojtëse personale për përballimin situatës së Covid-19”- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj**, këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Farma Net Albania Sh.p.k me NIPT K92201080V dhe me ofertë 119,365,500.00 lekë pa tvsh
2. T R I M E D Sh.p.k me NIPT K51612031J dhe me ofertë 158,578,191.45 lekë pa tvsh
3. MONTAL Sh.p.k me NIPT J62009007F dhe BIOMETRIC ALBANIA me NIPT J61827062E dhe me ofertë 178,448,700.00 lekë pa tvsh me përfaqësues BOE MONTAL
4. EUROMED Sh.p.k me NIPT K71718012P dhe me ofertë 189,910,000.00 lekë pa tvsh
5. O.E.S DISTRIMED Sh.p.k me NIPT K31520054N me ofertë 200,233,400.00 lekë pa tvsh
6. E v i t a shpk me NIPT L31714005J dhe me ofertë 303,215,000.00 lekë pa tvsh
7. FUFARMA Sh.a me NIPT J61825037N dhe me ofertë 319,999,800.00 lekë pa tvsh
8. I N T E R M E D Sh.p.k me NIPT J71424020D dhe me ofertë 359,533,908.00 lekë pa tvsh

9. MALBERTEX Sh.p.k me NIPT K71821009N & UNIVERS PROMOTIONS Sh.p.k me NIPT K81324039M &ALPHA Sh.p.k me NIPT 0510777950 me ofertë 374,828,400.00 lekë pa tvsh me përfaqësues BOE MALBERTEX
10. G & F Group shpk me NIPT L12004502N me ofertë 511,106,000.00 lekë pa tvsh
11. ELTIAN 2009 Sh.p.k me NIPT K92702402C pa oferte ekonomike
12. W.CENTER Sh.p.k me NIPT K63029402A pa oferte ekonomike

* * *

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. T R I M E D me NIPT K51612031J dhe me ofertë 158,578,191.45 lekë pa tvsh
2. EUROMED me NIPT K71718012P dhe me ofertë 189,910,000.00 lekë pa tvsh
3. FUFARMA me NIPT J61825037N dhe me ofertë 319,999,800.00 lekë pa tvsh
4. MALBERTEX me NIPT K71821009N & UNIVERS PROMOTIONS me NIPT K81324039M &ALPHA me NIPT 0510777950 me ofertë 374,828,400.00 lekë pa tvsh me përfaqësues BOE MALBERTEX
5. G & F Group shpk me NIPT L12004502N me ofertë 511,106,000.00 lekë pa tvsh
6. ELTIAN 2009 me NIPT K92702402C pa oferte ekonomike
7. W.CENTER me NIPT K63029402A pa oferte ekonomike

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. T R I M E D me NIPT K51612031J dhe me ofertë 158,578,191.45 lekë pa tvsh

- Artikujt 5 dhe 6 me prodhues SIMTEX AG. ISO 9001:2015 e paraqitur nga ky OE per prodhuesin Simtex ka si scope: Personal care manufacturing, sales, presentation and marketing services. Ne DT kerkohet: 2.3 Kapaciteti teknik: pika 4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent, ose ISO 13485 “Per Sistemin e menaxhimin te cilesise per pajisjet mjekësore”, /ose ekuivalent/, të vlefshme, për prodhuesin/t e artikujve të ofruar. Nuk ploteson kriterin.
- ISO 9001-2015 per prodhuesin per Artikullin 4 (Syze mbrojtese) dhe artikullin 8 (Ekran mbrojtës), kur kontrollon certifikaten ne sistem nuk del me te njejtin scope qe eshte paraqitur dokumenti ne SPE por me scope: production of disposable protective masks (non-medical) and KN95 protective masks (non-medical). Certifikatat per keto produkte nuk dalin ne sistem.
- Nuk ka dorezuar asnje dokumentacion per artikullin 7: Tyvek per prodhuesin Duruteks; - skualifikohet per kete prodhues per kete artikull.
- Nuk ka dorezuar Autorizim Prodhuesi dhe Certificate Konformiteti per artikullin 7: Tyvek per prodhuesin Sintex si dhe ISO per kete prodhues per kete artikull ka objekt tjeter; - skualifikohet per kete prodhues per kete artikull, kualifikohet per prodhuesit e tjere.

2. EUROMED me NIPT K71718012P dhe me ofertë 189,910,000.00 lekë pa tvsh

- Artikulli 2: Doreza nitrile (prodhuesi Primus), trashesia e tyre eshte kerkuar ne DST 0.1-0.12mm (ishte 0.12mm ne DST fillestare por u ndryshua si pasoje e ankeses per DST nga OE Biometric Albania), produkti i OE Euromed eshte me trashesi 0.05mm, pra sa gjysma minimale te trashesise se kerkuar ne DST (“sterile, pa puder ngjyre blu ose lejla me trashesi me diapazon 0.1 mm - 0.12 mm, duhet te jene me te trasha se sa normalet per pune ne laborator Masa M” - Njësia “Copë”, Sasia totale 12 muaj: 8000 cope). Per kete artikull nuk eshte dorezuar katalog por vetem skede teknike (qe shoqeron katalogun), e pamarkuar dhe specifikimet nuk gjenden, por citohen copy paste sipas DST ne pjesen e perkthimit! – skualifikohet per kete artikull.
- Ka ofertuar sipas DST fillestare dhe nuk ka pasqyruar modifikimet (u ndryshua si pasoje e ankeses per DST nga OE Biometric Albania sepse prodhues te ndryshme mund te kishin konfeksione te ndryshme), pra nuk ka ofertuar si gjithë operatorët e tjere por i ndryshon oferta (Artikulli 2: doreza; sasia jo cope, por kuti me 100 cope secila) pasi ky operator nuk ka mare modifikimet e ngarkuara nga AK qe kane ardhur si pasoje e ankesave te OE per DST. Edhe pse sasia ne total e dorezave te ofertuara eshte ok, OE jane te detyruar qe t’i pergjigjen te gjitha kerkesave te AK sikurse i jane pergjigjur te gjithë operatorët e tjere pjesemarrës ne kete procedure.

Në nenin 53, pika 1 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”;

Sipas Seksionin 1 të Dokumentave Standarde të Tenderit “Hartimi i ofertës”:

“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.”

- Per artikullin3: Maska FFP3 prodhuesi Golden Leaves, autorizimi i Distributorit te Autorizuar per OE-ne rezulton pa firme dhe vule dhe kopja origjinale me ate te perkthyer mbajne data te ndryshme; -skualifikohet per kete prodhues per kete artikull.

3. FUFARMA me NIPT J61825037N dhe me ofertë 319,999,800.00 lekë pa tvsh

- Sigurimi i ofertës eshte vetëm ne emër te OE Fu Farma dhe jo te BOE Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se:
“Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë....”
- Scope i Fufarmes ne certifikaten ISO 9001-2015 eshte “Trade storing administrative control and distribution of medicines and pharmaceutical products” dhe jo sikurse kerkohet ne DT 2.3 Kapaciteti teknik: pika 4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë

Certifikatë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent, ose ISO 13485 “Per Sistemin e menaxhimit te cilesise per pajisjet mjekësore”, /ose ekuivalent/, të vlefshme, për prodhuesin/t e artikujve të ofruar.

- OE BIODUE ka si objekt te veprimtarise se kompanise “Manufacture of perfumes and toilet preparations (Biodue_SpA_Company_registration_Report_25_09_2020) dhe nuk e ka si objekt ne fushe veprimtarie objektin e prokurimit;
- OE nuk ploteson kriterin e puneve te ngjashme. Faturat e paraqitura jane fatura tregetim rarna dhe nuk konsiderohen pune te nje natyre te ngjashme ne proceduren per MMP/ pajisje mjekësore

4. MALBERTEX me NIPT K71821009N & UNIVERS PROMOTIONS me NIPT K81324039M & ALPHA me NIPT 0510777950 me ofertë 374,828,400.00 lekë pa tvsh me përfaqësues BOE MALBERTEX

- Maskat nuk janë FFP3/FFP2/N95, por janë maska te thjeshta kirurgjikale (sipas katalogut), edhe certifikata CE eshte per te tilla maska.
- Formulari i ofertes i paraqitur, eshte oferte individuale dhe i referohet vetem OE MALbertex, dhe jo ofertuesit BOE, pra nuk eshte ne emer te tre operatoreve te BOE, sipas Marrveshjes se bashkepunimit. Kjo eshte ne kundertshtim me kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.) Kjo oferte, eshte ne kundertshtim me piken 4, neni 74 i VKM 914, date 29.12.2014, ku anetari i BOE nuk mund te paraqese oferte individuale.

5. G & F Group shpk me NIPT L12004502N me ofertë 511,106,000.00 lekë pa tvsh

- OE nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar ne DST (mungojne deklarate, kataloge, vertetim OSSHE, sigurim oferte, autorizimi nga MSHMS).
- Nuk ploteson xhirot e 3 viteve sa 40% e FL.

6. ELTIAN 2009 me NIPT K92702402C pa oferte ekonomike

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokumentacion sipas DT.

7. W.CENTER me NIPT K63029402A pa oferte ekonomike

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokumentacion sipas DT.

* * *

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 02.11.2020

Ankesa: Po (Intermed Sh.p.k)

(nëse ka) ka marrë përgjigje: në datë 10.11.2020 (nga AK) dhe Vendimi i KPP 541/8/2020, datë 28.12.2020.

- **Ankesa në KPP**

- Datë 19.11.2020
- Me vendimin e KPP 541/2020 datë 27.11.2020 KPP ka bërë skualifikimin e katër operatorëve dhe ka lënë si ofertë të vlefshme vetëm atë të operatorit ankimues Intermed shpk. Me shkresën Nr. 3324/46 Prot. datë 11.12.2020 AK bën me dije KPP-në që ka zbatuar vendimin, por edhe ka skualifikuar operatorin e vetëm të mbetur të kualifikuar në këtë mënyrë duke i vendosur të gjithë operatorët në kushte të barabarta, sipas procesverbalit të mbajtur nga KVO datë 07.12.2020, përcjellë KPP-së. KVO vlerëson të theksojë disa çështje sa i takon arsyetimit që KPP i ka bërë Vendimit të tij 541/6/2020 dhe veprimeve të KVO/AK pas Vendimit paraardhës të KPP (541/2020), duke skualifikuar edhe operatorin ankimues “Intermed shpk”:
 - i. KPP në pikën II.1 të Vendimit 541/6/2020, arsyeton se AK ka skualifikuar gjithashtu edhe OE ankimues “Intermed shpk” sipas arsyetimit të cituar në shkresën e sipërcituar të AK-së: në respekt të të njëjtave parime të përzgjedhjes së aplikuar nga KPP, për vlerësimin e disa prej OE-ve të tjerë pjesëmarrës duke kompromentuar kështu zbatimin e ligjit të ‘Par condicio Concurrentium’,
 - a. Ky konstatim i KPP-së është i gabuar pasi AK nuk e ka skualifikuar OE ankimues “Intermed shpk” me arsyetimin në shkresë, por me arsyetimin e zgjeruar në proceverbalin e KVO-së të datës 7.12.2020 (përcjellë KPP-së bashkëlidhur shkresës së sipërcituar të AK/MSHMS). Arsyetimi i dhënë në procesverbalin e KVO-së, për të cilin kjo e fundit u investua në respekt të frymës së zbatimit të Ligjit dhe integritetit personal e profesional, analizonte në zëra kontratat tashmë jo të ngjashme, por ‘të njëjta’ sipas standartit të vendosur me Vendimin e KPP-së 541/2020, të OE ankimues “Intermed shpk”. Pra, KVO i ka bërë me dije KPP-së se edhe ky operator ndodhet në të njëjtat kushte si dhe operatorët e tjerë të cilët janë skualifikuar nga vendimi KPP 541/2020, për këtë arsye KVO vijoi me skualifikimin e këtij të fundit në SPE.
 - ii. KPP në pikën II.1.2 të Vendimit 541/6/2020 citon nenin 35 të Vendimit të KPP nr. 596/2018 datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik””, sa i takon mundësisë apo të drejtës që AK ka për të kërkuara rishikim të Vendimit brenda 10 ditëve nga marrja e tij,

KVO dëshiron të theksojë se kërkesa që AK është e legjitimuar të bëjë për rishikim Vendimi të KPP-së lidhet me objektin e Vendimit, por AK duke qenë e vetëdijshme se Vendimet e KPP-së janë përfundimare nuk ka kërkuar rishikim Vendimi për objektin e ankesës por e ka bërë me dije KPP-në se për shkak të Vendimit që lidhej strikt me objektin e ankesës, është çënuar procedura e vlerësimit në tërësi. Nga ana tjetër, në zbatim të Vendimit të KPP nr. 596/2018 datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik””, “neni 4, “Parimet e veprimtarisë”, pika 1:

1. Në veprimtarinë e tij, Komisioni respekton parimet e:

...

b) **barazisë dhe mosdiskriminimit;**

c) paanshmërisë në shqyrtimin e ankesave

d) **qëndrueshmërisë në vendimmarrje**

...”

Sërish, në zbatim të Vendimit të KPP nr. 596/2018 datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 30, “Kufijtë e shqyrtimit të ankesës”, pika 2:

2.Përrjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.

Sërish, në zbatim të Vendimit të KPP nr. 596/2018 datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 31, “Vendimi i Komisionit”, pika 2:

“2. Nëse Komisioni vendos sipas pikës 1 shkronjës “b” të këtij neni me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ligjin 9643/2006, dhe kontrata e prokurimit ende nuk është lidhur, **atëherë Komisioni ka të drejtë:**

a) **Të interpretojë rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, duke udhëzuar autoritetin kontraktor të veprojë sipas këtij interpretimi në vazhdimin e procedurës së prokurimit;**

b) Të anulojë plotësisht ose pjesërisht vendimin ose veprimin e autoritetit kontraktor të nxjerrë në kundërshtim me ligjin, si dhe të udhëzojë vazhdimin e procedurës së prokurimit në përputhje me ligjin, duke treguar veprimet që duhet të kryhen në vijim;

c) Të konstatojë shkeljen ligjore konkrete dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor mbi korrigjimin e tyre, si dhe për vazhdimin e procedurës së prokurimit

...”

iii. KPP në pikën II.1.3 të Vendimit 541/6/2020 shprehet se ‘..procedura përpara AK si dhe para KPP ka natyrën e procedurave të nxitura pra lat.-jurisdicion voluntari’ pasi AK dhe vetë KPP-ja nuk mund të bëhen vetë iniciatore të procedurave ex officio. Si rregull, investimi i KSHA dhe KPP është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjituara.

KVO vlerëson të theksojë se ka pasur praktika të mëparshme të KPP, me të njëjtën përbërje anëtarësh sikundër edhe sot, ku ky organ kolegjal me iniciativën e vet ka korrigjuar/rishikuar siç është rasti i Vendimit të K.P.P. 325/2/2020 me objekt Korrigjim Vendimi, ku KPP shprehet se: “I.1. Me nismën e vetë organit administrativ, nga Komisioni i Prokurimit Publik....”.

KVO, vendos:

Në zbatim të Vendimit të KPP nr. 596/2018 datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 35, **“Karakterit detyrues i vendimeve të Komisionit”:**

“Autoritetet kontraktore, nëse brenda 10 ditëve nga marrja dijani, nuk kërkojnë pranë Komisionit rishikimin e vendimit të tij, **janë të detyruara ta zbatojnë atë në përputhje me urdhërimet e tij.:**

dhe Sikurse KPP shprehet në Vendimin e tij se AK duhet të kryejë rivlerësimin e procedurës bazuar vetëm në konstatimet në Vendim sipas pikës 2 të dispozitivit. Gjithashtu KPP gjen me vend të sqarojë se në mbështetje të dispozitave ligjore të lartpërmendura, AK janë të detyruara të zbatojnë me rigorozitet vendimit e KPP dhe të kryejnë rivlerësimin e ofertave konform konstatimeve të pasqyruara në këto Vendime, **duke qenë se tagri ligjor për veprimin e KVO në këtë pikë ka përfunduar pasi është kufizuar nga vendimet e KPP dhe gjithë fryma e vlerësimit është tjetërsuar**, atëherë KVO zbaton pa interpretim Vendimin, duke ju vënë edhe një herë në dijeni të gjithë arsyetimet përkatëse.

Përfundimisht renditja, pas rivlerësimit të datës 24.12.20 në zbatim të Vendimit të KPP 541/6/2020, është si më poshtë:

- W.Center pa ofertë		i skualifikuar
- Eltian 2009 pa ofertë		i skualifikuar
- Farma Net Albania shpk 119,365,500 leke pa tvsh		i skualifikuar
- Trimed shpk 158,578,191.45 leke pa tvsh		i skualifikuar
- BOE “Montal shpk”&“Biometric Albania shpk”	178,448,700 leke pa tvsh	i skualifikuar
- Euromed shpk 189,910,000 leke pa tvsh		i skualifikuar
- O.E.S. Distrimed shpk 200,233,400 leke pa tvsh		i skualifikuar
- Evita shpk 303,215,000 leke pa tvsh		i skualifikuar
- Fufarma shpk 319,999,800 leke pa tvsh		i skualifikuar
- Intermed shpk 359,533,908 leke pa tvsh		i kualifikuar
- BOE “Malbertex”&“Univers Promotions”&“Alpha”	374,828,400 leke pa tvsh	i skualifikuar
- G&F Group 511,106,000 leke pa tvsh		i skualifikuar

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **I N T E R M E D me NIPT J71424020D dhe me adresë, rruga Ismail Qemali 12/1, Tiranë**, se oferta e korigjuar me një vlerë totale prej **359,533,908 (treqind e pesëdhjetë e nente milion e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e nenteqind e tete) Leke pa TVSH/pikët totale të marra [_____]**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [autoritetit kontraktor përfitues] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Gelardina Prodani